



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 22 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Haki Demolli, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arben Gashi, Mufera Šinik, Amir Ahmeti dhe Albulena Haxhiu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Fahrije Bajrami – Praktikante, Feride Podvorica – MD, Lumnije Murati – ZPRK, Arben Shamolli – ISKP dhe Shkëlzen Gerxhaliu – Praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për avokaturën shtetërore;
3. Formimi i grupit punues në Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;
4. Formimi i grupit punues në Projektligjin për provimin e jurisprudencës;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për avokaturën shtetërore

Armend Zemaj – Vlerësoi se Projektligji mund të procedohet për lexim të parë edhe pse ka disa zbrazësi në përmbajtje, të cilat mund të plotësohen me vërejtjet e deputetëve dhe grupeve parlamentare. Në vazhdim tha se duhet kujdes sa i përket përmbajtjes dhe avancimit se si do të strukturoret avokatura shtetërore në raport edhe me ligjet e tjera.

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për avokaturën shtetërore dhe vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim, prandaj vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji për avokaturën shtetërore.

3. Formimi i grupit punues në Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, në përbërje:

Behar Selimi – kryesues,

Haki Demolli – anëtar,

Albulena Haxhiu – anëtare,

Jasmina Živković – anëtare.

4. Formimi i grupit punues në Projektligjin për provimin e jurisprudencës

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për provimin e jurisprudencës në përbërje:

Armend Zemaj - kryesues,

Arsim Bajrami – anëtar,

Halit Krasniqi – anëtar,

Albulena Haxhiu – anëtare.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

Armend Zemaj -Tha se nuk mund të japë qëndrim për faktin se amendamenti 1 i shton rreth 3 anëtarë, që me gjasë kanë të bëjnë me marrjen e vendimit rreth dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim ose këmbim. Prandaj duhet ta kenë të qartë se kur kemi prekje të legjislacionit vital duhet të jetë i përfshirë edhe amendamenti bazë dhe plotësim-ndryshimi, për shkak se nuk mund të vijmë në përfundim nëse themelimi i një komisioni të tillë prek kushtetutshmërinë ose ligjshmërinë, pa e ditur bazën juridike të dy ligjeve bazë të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion me pesë vota “ për “ dhe “ 1” abstenuar nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Amendamenti i propozuar e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentin e propozuara mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme

Armend Zemaj – Propozoi që për projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale edhe projektligjin për provimin e jurisprudencës të organizohen dëgjime publike.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Behar Selimi